



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**K.DH.SH.II.nr.835/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Faton Bajrami kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit / propozuesve të masës së sigurimit: Komuna e Shtimes, me seli në rrugën “Tahir Sinani” nr.50, në Shtime, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson L.Z. avokat nga Prishtina, ndaj të paditurit/kundërshtarit të masës së sigurimit Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re”, SH.A., me seli në Lagjen Kalabria nr.5 në Prishtinë, e përfaqësuar nga Likuidatori N.L., me objekt kontesti ekzekutimi i sigurimit te tenderit, vlera e kontestit 3,370.03 euro duke vendosur sipas ankesës të parashtruar nga ana e propozuesit, kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike, evidentuar si: KE.nr.565/23 të datë 11.09.2023, më 16.06.2024, merr këtë:

### **A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pa themeltë ankesa e paditësit / propozuesve të masës së sigurimit: Komuna e Shtimes me seli në Shtime, dhe **VËRTETOHET** aktvendimi i evidentuar si: KE.nr.565/23 të datë 11.09.2023, i Departamentit për Çështje Ekonomike të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë.

### **A r s y e t i m i**

Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin ankimor të evidentuar si: KE.nr.565/23 të datë 11.09.2023, ka vendosur si në vijim: NDËRPRITET procedura në çështjen juridike me numër KE.nr.565/23 e iniciuar sipas padisë dhe propozimit për caktimin e masës së sigurisë të datës 21.07.2023 të paditësit Komuna e Shtimes ndaj të paditurit Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re”, SH.A., për shkak të fillimit të procedurës së likuidimit të detyrueshëm të paditurit.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë propozuesi i masës së sigurimit, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktvendimi i atakuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Kundër-propozuesi nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 e lidhur me nenin 208 dhe 505.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në vijim LPK), ka gjetur se:

- **Ankesa është e pa themeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se propozuesi i masës së sigurimit Komuna e Shtimes, përmes të autorizuarit të tyre, me datë 21.07.2023, në këtë gjykatë, kanë paraqitur padi për ekzekutimin e sigurimit të tenderit në vlerë prej 3,370.03 €, si dhe propozimin për caktimin e masës së sigurimit, ndaj të paditurit/kundërshtarit të masës së sigurimit Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re”, SH.A. I padituri/ kundërshtari i masës së sigurimit, përmes likuidatorit me datën 24.08.2023, ka paraqitur përgjigje në padi, përmes të cilës e ka njoftuar gjykatën se ndaj të paditurit sipas Vendimit nr. 70-24/2021 të datës 24.08.2021 është hapur procedura e likuidimit të detyrueshëm, për shkak se siguruesit Kosova e Re, i është revokuar licenca nr. 007 e datës 25.04.2002. I ka propozuar Gjykatës që të ndërprehet procedura gjyqësore në kontestet në të cilat në cilësinë e palës së paditur apo të debitorit është Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re”.

Gjykata e shkallës së parë, lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurisë ka mbajtur seancën dëgjimore dhe ndërgjyqësit i kanë paraqitur pretendimet e tyre sa i përket bazueshmërisë së propozimit dhe pas përfundimit të seancës gjyqësore, ka marr aktvendimin e ankimuar duke u bazuar në dispozitën e nenit 277, par.1, pika d) të LPK-së, Nderpritet procedura në çështjen juridike si dhe duke arsyetuar aktvendimin e ankimuar se në rastin konkret rezulton se i padituri, i është nënshtruar procedurës së likuidimit të detyrueshëm, gjykata vlerëson se procedura në këtë çështje kontestimore duhet të ndërpritet, meqenëse i padituri ka marrë cilësinë e debitorit falimentues dhe është në procedurën e likuidimit.

Dhoma e Shkallës së Dytë nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Dhoma e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë e mori këtë qëndrim juridik sepse sipas Nenit 277, par.1, pika d) të LPK-së, përcaktohet se “ *Procesi gjyqësor ndërpritet: d) kur paraqitet propozimi për fillimin e procedurës së falimentimit në kontestet në të cilat i padituri është debitor falimentues*”.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, i vlerësoi edhe pretendimet tjera ankimore, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike duke dhënë arsye të mjaftueshme. Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë

vlerëson se aktvendimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij.

Andaj, bazuar në të lartcekurat dhe në mbështetje të dispozitës së nenit Nenit 277, par.1, pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke vërtetuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

**Dhoma e Shkallës së Dytë**

**K.DH.SH.II.nr.835/24, më 16.06.2024**

**Kryetar i kolegjit - Gjyqtari  
Faton Bajrami**